Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0016

PSH Nr. 2024/0016 dhe 2024/0035

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Kompania Prishtina" Sh.p.k, dhe OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Ministria e Punëve të Brendshme" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve" me numër të prokurimit 214-23-9615-5-1-1, me datë 11.04.2024 merr këtë:

Vendim

1.**Aprovohet**, si të bazuar ankesa e OE "Kompania Prishtina" Sh.p.k, me nr. 2024/0016, e datës 05/01/2024 kurse vendimi i AK "Ministria e Punëve të Brendshme", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve" me numër të prokurimit 214-23-9615-5-1-1.

2. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K. me nr. 2024/0035, e datës 09/01/2024, lidhur me aktivitetin e cekur në pikën I të dispozitivit.

3. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve" me nr. të prokurimit: 214-23-9615-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Ministria e Punëve të Brendshme"dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

4. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

5. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Kompania Prishtina" Sh.p.k dhe "NIKA PrO- Ing" SH.P.K.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 21.09.2023, "Ministria e Punëve të Brendshme" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve" me numër të prokurimit 214-23-9615-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 527,022.50 €.

Me 20.12.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë "Standard Beton SHPK & Arifaj Shpk".

Me 26.12.2023, OE "Kompania Prishtina" Sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 26.12.2023 po ashtu edhe OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 29.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 05.01.2024, OE "Kompania Prishtina" Sh.p.k ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0016/2024 ndërsa me datë 09.01.2025 OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0035/2024.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesat i përmbajnë elementet e parapara me nenin 111 të LPP dhe janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP, pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP. Meqë ankuesit ka statusin e palës së interesuar sipas nenit 4 paragrafi 1, nën-paragrafi 26 të LPP, kurse ankesat janë ushtruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër, të njëjtat bijnë nën kompetencat e këtij Organi përkitazi me shqyrtimin dhe vendosjen në mënyrë meritore, në kuptim të nenit 105 të LPP.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 01/24 dhe ankesa nr. 14/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me Nr.2024/0016 dhe Nr.2024/0035 ndërsa me datë 10.01.2024, respektivisht 16.01.2024 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 2024/0016 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 2024/0035 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues është deklaruar se nuk pajtohet mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa Operatori ekonomik janë pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në këtë rast Paneli mori paraprakisht konstatoi se AK ka zbatuar:

a. procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.37. të nenit 4, të LPP;

b. lloji i kontratës: Punë, sikurse parashihet me paragrafin 3, të nenit 27, të LPP;

c. vlera e parashikuar e kontratës: 527,022.50€ vlere e madhe, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.28 të nenit 4, lidhur me paragrafin 1, të nenit 19, të LPP

d. Kriteri i dhënies së kontratë është çmimi ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas peshës së kritereve të përshkruara në Aneksin 6 të dosjes së tenderit.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Paneli shqyrtues (në përbërje kolegjiale) administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

Pohimet ankimore te Ankuesit "Kompania Prishtina" Sh.P.K.&

Ankuesi aludon në papërgjegjshmërinë e GOE të rekomanduar për kontratë si dhe AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me këtë sepse Grupit të OE i propozuar me kontratë sipas vendimit date 20.12.2023, ka bëre ndërhyrje në paramasë dhe parallogari në kundërshtim të plotë me ligjin e LPP-së, UPP Nr. 001/2023 dhe RRPP Nr.001/2022. GOE me rastin e ofertimit ndërhyn në paramasë duke ndryshuar sasinë tek Punët e Instalimeve gjegjësisht 4. Makineria-2.0. Instalimet e Brendshme, pozicioni 2. Sipas FDT-së Pjesa e II-të, sasia në paramasë është 0.40 %, kurse nga GOE është ndërhyrë në kundërshti të plotë duke zvogëluar në 0.04%. Sipas GOE-së “Standard Beton” me te tjerë, me rastin e ofertimit, respektivisht të plotësimit të paramasës në pozicionin e theksuar me lartë dhe të ilustruar më poshtë me ngjyrë ka ndërhyrë (ka ndryshuar) paramasën e dhënë nga AK prej 0.4 % dhe e ka bërë 0.04 %. Lidhur me këtë pretendim të ankuesit AK është

përgjigjur se Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nga AK-MPB, ka plotësuar në harmoni me LPP Pjesa I. Formularin e Tenderit ju sqarojmë së nuk kemi të bëjmë me asnjë ndërhyrje në paramasë ashtu siç pretendoni ju po kemi të bëjmë me pozicione të cilat duhet të kalkulohen me përqindje (%) dhe e njëjta është korrigjuar nga komisioni përmes dokumentit B49 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit Llogaritje e gabuar dhe Grupi i OE-vë të rekomanduar për kontratë nga AK-MPB ka konfirmuar dhe është pajtuar për shkak të gabimeve të bëra gjatë llogaritjeve, domethënë shuma e përqindje së llogaritjes është 0.47 % përqindje e cila është në përputhjes të plotë me LPP-së Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shume se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e pare sqaron se, ne ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet paramasa ne PDF e cila siç pretendon edhe OE ankuesi, ka ndërhyrje tek pika 2 ne paramase, për faktin se paramasa e standardizuar e AK-se ne E-prokurim ka te kalkuluar sasitë dhe përqindjen, dhe si e tillë nuk duhet te ndryshohen përmbajtjet e qelizave, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar. Paneli shqyrtues lidhur me këtë pretendim ankimore i verifikon këtë deklarata të ankuesit dhe në bazë të dokumentacionit të ofertuesit (paramasës dhe parallogarisë) konsideron se GOE të rekomanduar për kontratë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke u bazuar edhe në nenin 44.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Për Panelin shqyrtues kjo ndërhyrje nuk mund të kualifikohet si gabim aritmetik nga ana e AK, ku me qëllim/pa qëllim gabimisht i referohet dispozitave ligjore sepse neni 40, respektivisht paragrafi 40.10 i Rregullores së lartcekur i sqaron gabimet aritmetike dhe e zbërthen nenin 59 të LPP, i cili është i përgjithësuar dhe të cilin e ka cituar AK. Andaj, Paneli Shqyrtues këtë pretendim të ankuesit e kualifikon si të bazuar dhe GOE të cilin e ka rekomanduar AK për kontratë është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e sheh si të panevojshme dhe nuk do të lëshohet në pretendimet tjera ankimore ndaj GOE të rekomanduar për kontratë.

Pohimet ankimore te Ankuesit "NIKA PrO- Ing" SH.P.K.

Ankuesi atakon eliminim e tij/saj ku sipas AK ankuesi është eliminuar ngase në formularin e tenerit dhe në procesverbalin e hapjes jeni vetëm si OE, ndërsa në dokumentacionin e dorëzuar jeni Grup i OE NIKA PrO-ing SHPK & PRO & CO GROUP, andaj themelimi i Grupit të Konzorciumit është në kundërshtime me dispozitat ligjore të LPP si dhe aktet tjera nënligjore për Prokurim Publik. Ankuesi po ashtu përmend faktin duke pranuar gabimin e tyre të cilin e quajnë si gabim teknik.Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, OE ankues në ofertë ka të bashkangjitur deklaratat e konzorciumit, deklaratat nën betim, dokumentet e biznesit për dy operatorët në konzorcium, që vërehet se i njëjti aplikon si konzorcium, mirëpo gjatë aplikimit në e-prokurim ka bërë gabim teknik gjatë aplikimit, ku në formularin e gjeneruar nga sistemi nuk ka të shtuar anëtarin e konzorciumit, gjerësa tek pjesa Formular për dorëzim të tenderit gjenden të gjitha informatat lidhur me titullin e aktivitetit të prokurimit, numrin e prokurimit, çmimin e ofertës, atëherë si e tillë, meqenëse në LPP pjesa teknike e E-prokurimit nuk specifikohet si e tillë konsideroj se AK në rivlerësim duhet të sqarohet me KRPP-në lidhur me gabimet teknike të procesuara në E-prokurim. Këtë konstatim jo profesional dhe jo ligjore të Ekspertes Shqyrtuese

nuk mund të pranohet nga ana e këtij Paneli Shqyrtues, andaj Paneli vlerëson se AK me të drejtë ka eliminuar nga gara OE duke u bazuar edhe në dispozita ligjore, e konkretisht tek Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, me çrast Paneli Shqyrtues e citon këtë dispozitë ashtu sikurse e ka cituar edhe AK, "Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon, Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, Kusht administrativ". Andaj, OE ankues është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Ankuesi po ashtu atakon eliminimin e tij per Inxhinier i diplomuar ose Master i Elektroteknikes drejtimi automatike min 3 vite përvojë pune dhe Inxh. I diplomuar ose Master i Emergjencave min3 vite përvojë pune duke aluduar se këta inxhinier i ka pasur ne listën e stafit profesional mirëpo me gabim teknik nuk i kemi ngarkuar.Ekspertja Shqyrtuese lidhur me arsyen e eliminimit për inxhinierët të elektroteknikes dhe ing. Master i Emergjencave, sqaron se, AK ka kërkuar sqarime, për të cilat OE ankues i ka bashkangjitur të gjitha dokumentet konform kërkesës së AK-së, të cilat konsideroj mund të merren të mirëqenë, konform nenit 72 të LPP-së, për faktin se në ofertë para hapjes, OE në listën e stafit ka të specifikuar emrat e inxhinierëve. Paneli Shqyrtues edhe këtë konstatim të ekspertes shqyrtues nuk e mbështet, konstatim ky i cili me qëllim/pa qëllim është i nxjerr duke mos i marrë për bazë përgjigjet e AK në kërkesën për ri-shqyrtim si dhe arsyet e eliminimit në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Ngase AK komisioni i vlerësimit për të vlerësuar tenderin ka njoftuar se ka kërkuar sqarime shtesë bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-së, për pikat e lartcekura cekura me datën 21.11.2023 dhe me datën 24.11.2023 dhe OE tani ankues ka dorëzuar dokumentacioni/dëshmitë të cilat nuk janë të mjaftueshme me kërkesat të NjK, DT-së dhe Sqarimeve, sepse Marrëveshjet e ofruara për këtë. projekt për stafin e lartshënuar nuk përmbajnë asnjë datë që vërteton ekzistencën e tyre para hapjes dhe si të tilla janë të pa pranueshme 72 pik 3. Sigurimi i Informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë Objektive. Dhe këto dokumente nuk kanë asnjë dëshmi datë të fiksuar që dëshmojnë ekzistencën e tyre para datës se hapjes se ofertave andaj me te drejt komisioni ka vendosur për mospranimin e tyre. Andaj, Paneli Shqyrtues e mbështet këtë arsyeshmëri të AK i cili është i bazuar me fakte prova dhe i mbështetur me dispozita ligjore.

Po ashtu, vlen të theksohet se OE ankues "NIKA PrO – Ing SHPK, prinë për nga numri më i madh i ankesave të adresuara në OSHP dhe nuk është hera e parë që evidentohet nga ana e Paneleve Shqyrtuese se pretendimet ankimore i ka të qëllimshme vetëm për të prolonguar proceset e prokurimit publik dhe ofertat e tija i ka të papërgjegjshme duke mos i kompletuar fare. Në rast se kjo vazhdon në të ardhmen OSHP do të ndërmarr masa dhe të vë në zbatim nenin 31, paragrafin 7 të Rregullores së Punës së OSHP.

Ndërsa në pretendimet tjera të ankuesit kundrejt GOE të rekomanduar për kontratë Paneli Shqyrtues nuk do të lëshohet në vlerësimin e tyre, ngase GOE të rekomanduar për kontratë ka rezultuar si i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, edhe pse ekspertja shqyrtues ka konstatuar se një pjesë e këtyre pretendimeve ankimore gjenden të bazuara.

- Përfundim-

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët konsideron se shumica e gjetjeve të ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli. Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin

106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues i cili kanë paqartësi me kërkesat dhe me specifikat e kërkuara DT, do duhej që në fazën paraprake, ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtrojë pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK.

Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë. Kjo siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjithë palët e interesuara. Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit.

Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik përderisa po ky aktivitet i prokurimit i është nënshtruar dy here procesit të rivlerësimit. Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **" Kompania Prishtina " Sh.p.k, NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: